



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E MBROJTJES SË TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E MBIKËQYRJES NË FUSHËN E DREJTËSISË PENALE DHE SIGURSË
PUBLIKE

Nr. 2580/1 prot.

Tiranë, më 13.12.2024

Lënda: Dhënie mendimi mbi projektvendimin *“Për përcaktimin e përbërjes, funksioneve dhe procedurës së Komisionit për shqyrtimin e kërkesës për njohjen e një pakice kombëtare”*

MINISTRISË SË BRENDSHME

Tiranë

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim *“Zyra e Komisionerit”*) ka administruar shkresën tuaj nr.13013 prot., datë 06.12.2024, protokolluar me tonën me nr. 2570 prot., datë 10.12.2024, me anë të së cilës dërgoni për mendim projektvendimin *“Për përcaktimin e përbërjes, funksioneve dhe procedurës së Komisionit për shqyrtimin e kërkesës për njohjen e një pakice kombëtare”*, si dhe relacionin shoqërues.

Nga shqyrtimi i përmbajtjes së projektligjit dhe relacionit shoqërues vërejmë se proceset përpunuese të të dhënave personale të parashikuara në këtë projektvendim vijnë në zbatim të neneve 6 dhe 7, të ligjit nr.96/2017 *“Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”* ky i fundit legjitimon administrimin dhe mbledhjen e të dhënave, nëpërmjet vetëidentifikimit dhe ndërveprimit me baza të tjera të dhënash shtetërore, si Gjendja Civile

Megjithatë, lidhur me formatin e *“Formularit të Vetëidentifikimit të individit, shtetasit shqiptarë për njohjen e një pakice kombëtare”*, të cilën e dërgoni bashkëlidhur këtij projektvendimi, sugjerojmë që në fund të shtohet një paragraf me përmbajtje: *“Të dhënat e grumbulluara nga ky formular, do të përdoren vetëm për përmbushjen e qëllimit fillestar për të cilin ato mblidhen”*.

Me reflektimin e sugjerimit të mësipërm, vlerësojmë se, në tërësi, projektvendimi është hartuar në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi